

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" Global Forex" SH. P.K

Sot, me date 19.02.2025, une i nenshkruari:

EDLINA KAVO shtetase Shqiptar, i bija e Nezir e Zime e datelindjes 10.04.1976 , lindur ne Krej-Lure Diber dhe banues ne Kamez, Tirane e identifikuar nga leternjoftimi me numer H65410137H madhor e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Ne perputhje me ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", te ndryshuar kam vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar "**Global Forex**" Sh.p.k.(me poshte referuar si "Shoqeria"), duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akt Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte "**Global Forex**" SH.P.K

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Tirane,Njesia Administrative Nr 11 , Rruga Kastriotet,zona kadastrale 8320 ,Nr. Pasurie 6/7-N5, Institut Bujqesor. Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:



- Zyre kembimi valutor.
- Agjent i shërbimi komisioner, transfera parash për llogari të një subjekti jo banke .
- Agjensi udhëtimi ,biletari
- Aktivitet në kryerjen e operacioneve tregtare dhe industriale,financiare .
- Rimbushje të telefonisë celulare, pagesa të ndryshe për të tretet.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 2500000 (dy milion e pesëqindmijë) leke, i zotëruar 100% nga ortakët i vetëm i saj **Znj.EDLINA KAVO**.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (një) pjesë kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, me vlerën prej 2500000 (dy milion e pesëqindmijë) leke.

Neni 6

Dërdhja e kapitalit themeltar është bërë pranë Bankës.

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve të interesit apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 8

Shoqëria administrohet nga Administratori i shoqërisë

EGLANTINA XHAFERRI shtetas Shqiptar, e bija e Gezim e Sheribe e datelindjes 03.09.1989, lindur në Klos, Mat dhe banues në Kamez, Tiranë e identifikuar nga leternjoftimi me numër 195903099U madhor e me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërsëritjeje.

Administratori ka liri të plote për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshjeje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të



parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Vendimit te Ortakut te Vetem. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Neni9

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise ibesohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni10

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe,nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise.

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE " Global Forex" SH. P . K

EDLINA KAVO

